5756
16.06.2026

11

Ilonfurmohet
Eva Sefo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LUSHNJE

RELACION
PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK
MBI MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BASHKISË LUSHNJË 2026–2031

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltar!

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore në fuqi, paraqitet për miratim Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë për periudhën 2026–2031.

Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë përbën dokumentin kryesor të planifikimit strategjik vendor, i cili orienton zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe institucional të territorit të bashkisë në një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë. Dokumenti është hartuar mbi bazën e analizës së situatës aktuale, identifikimit të potencialeve dhe sfidave të territorit, si dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe rajonale të zhvillimit.
Hartimi i strategjisë është realizuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke përfshirë analizën e të dhënave demografike, ekonomike, sociale dhe mjedisore, konsultimet me strukturat administrative të bashkisë, aktorët lokalë dhe grupet e interesit. Dokumenti bazohet në metodologjinë e analizës së gjendjes aktuale, analizës SWOT, formulimit të vizionit të zhvillimit, objektivave strategjike dhe planit të veprimit me masa konkrete për zbatim.
Strategjia përcakton një vizion të qartë zhvillimi, i cili synon transformimin e Bashkisë Lushnjë në një territor konkurrues, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, ku zhvillimi ekonomik mbështetet në modernizimin e bujqësisë, agro-përpunimit, zhvillimin e turizmit rural dhe shfrytëzimin e potencialeve lokale, ndërsa qytetarët përfitojnë shërbime cilësore dhe një mjedis të sigurt e të shëndetshëm. Gjithashtu janë përcaktuar prioritete strategjike që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit, përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, mbrojtjen e mjedisit dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përfshirjen sociale, si dhe forcimin e qeverisjes vendore dhe kapaciteteve institucionale.
Në fushën ekonomike, strategjia synon mbështetjen e fermerëve dhe sipërmarrjeve vendore, rritjen e vlerës së produkteve bujqësore përmes agro-përpunimit, përmirësimin e aksesit në tregje dhe

nxitjen e investimeve private. Gjithashtu, dokumenti promovon zhvillimin e agroturizmit dhe ekoturizmit si sektorë plotësues të ekonomisë lokale. Në aspektin social, strategjia parashikon masa për rritjen e aksesit në arsim, shëndetësi, kulturë dhe shërbime sociale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve vulnerabël, grave, të rinjve dhe familjeve në nevojë. Njëkohësisht synohet forcimi i kohezionit social dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.
Në aspektin mjedisor, dokumenti parashikon rehabilitimin e sistemeve të menaxhimit të ujërave, mbrojtjen e tokës bujqësore, rritjen e eficiencës energjetike, promovimin e energjive të rinovueshme dhe ndërmarrjen e masave për përballimin e rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike dhe përmbytjet. Strategjia shoqërohet me një plan veprimi të detajuar, i cili përfshin projekte dhe masa konkrete të ndara sipas afateve kohore, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse për zbatim. Financimi i saj parashikohet të mbështetet nga buxheti vendor, programet kombëtare të investimeve, fondet e Bashkimit Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit.

Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë 2026–2031 do të krijojë bazën e nevojshme për orientimin e politikave zhvillimore të bashkisë, për planifikimin e investimeve publike dhe për koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve vendore, qendrore dhe partnerëve të zhvillimit. Ky dokument përfaqëson një instrument të rëndësishëm për rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të Bashkisë Lushnjë.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak Lushnjë të shqyrtojë dhe të miratojë Strategjinë e Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë për periudhën 2026–2031.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Përgjegjëse Njësisë për Hartimin e Projekteve
dhe Integrimin Evropian

Lidjona Krakulli

5756/1

16-06-2026

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

PROJEKT - VENDIM
NR. 58 Datë 16/06/2026

MBI MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BASHKISË LUSHNJË 2026–2031

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës ___/ 06/ 2026 , në mbështetje të nenit 16, pika "1", nenit 23, pika "4", nenit 28, pika "1" dhe nenit 54 shkronja " k" të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, VKM nr.88 datë 22.02.2023 " Për miratimin e strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Europian 2022-2030" Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar, Ligjin nr.9817/2017 "Për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit , Politikave Sociale dhe Informimit, për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje për periudhën 2026–2031,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin "Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnje 2026–2031".
2. Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnje 2026–2031 të shërbejë si dokument kryesor strategjik orientues për planifikimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe projekteve zhvillimore të Bashkisë Lushnjë gjatë periudhës 2026–2031.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë e Bashkisë Lushnje.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Përgjegjëse Njësisë për Hartimin e Projekteve dhe Integrimin Evropian
Lidjona Krakulli

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Kryetare e Bashkisë
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE